



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Terriorit

Nr. 2402 prot.

Pukë më 24/12/2020

PROJEKT-VENDIM

Nr. 05, Date 24/12/2020.

PËR
PROÇEDURAT E PRIORITETEVE PËR INVESTIME E SHËRBIME PËR VITIN 2021

Në zbatim të nenit 3, nenit 4, nenit 23, nenit 27, nenit 54, nenit 55, të ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisje Vendore" (i ndryshuar); Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; Ligjit nr.10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", (i ndryshuar); Ligji nr.9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar); Ligjit nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020"; Udhëzim nr. 30/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"; Udhëzimin nr.9/2018 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit" dhe parashikimeve për investime në PPV-në për Bashkinë Pukë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kwrkeswn:

VENDOSI:

Të miratojë listën e prioriteteve për investime e shërbime në Bashkinë Pukë për vitin 2021 si me poshtë vijon:

1. Ndërtim urë auto, fshati Pla, Njësia administrative "Luf-Qerret"
2. Ndërtim i një fushe sportive në hapësirën e shkollës Luf, Njësia administrative "Luf-Qerret"
3. Rehabilitim i rrugës së lagjes Buzhalë-Zorrrkal, fshati Kastallë, Njësia administrative "Luf-Qerret"
4. Rrethimi i varrezave fshati Luf, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
5. Rrethimi i varrezave fshati Ferth, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
6. Riparim ura këmbësore e Pemakëve, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
7. Riparim ura këmbësore Dush, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
8. Riparim ura këmbësore Ferth, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
9. Riparim ura këmbësore Brrakaj, Njësia Administrative "Luf-Qerret"

10. Riparim ura këmbësore Qut, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
11. Riparim ura këmbësore Pla, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
12. Shtrim me çakull rrugët rurale, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
13. Rehabilitimi vadiqtes, lagjia Djalosh, fshati Qerret, Njësia Administrative "Luf-Qerret"
14. Hapje degëzimi të ri rrugë auto rurale, lagjia Brigje, Fshati Gojan, Njësia Administrative "Gjegjan"
15. Ndërtim çezme publike Gjegjan, Njësia Administrative "Gjegjan"
16. Ndërtim ure auto Sherraj Hec Shutine, Njësia Administrative "Gjegjan"
17. Ndërtim muri mbajtës në rrugën Gojan i Vogël, lagjia Kodërkmone, Njësia Administrative "Gjegjan"
18. Tombino në lagjen Bardhagji, Gojan i Vogël, Njësia Administrative "Gjegjan"
19. Riparim ura pasarelë, lagjia Mikth, Gojan i Madh, Njësia Administrative "Gjegjan"
20. Riparim ura pasarelë, lagjia Zallajve, Kalivare, Njësia Administrative "Gjegjan"
21. Ngrohje me kaldajë shkolla e mesme Gjegjan, Njësia Administrative "Gjegjan"
22. Ngrohje me kaldajë shkolla e mesme Gojan i Madh, Njësia Administrative "Gjegjan"
23. Rikonstruksion i tualeteve të Njesisë Administrative "Gjegjan"
24. Rrethimi i varrezave të Kalivares, Njësia Administrative "Gjegjan"
25. Rehabilitim i kanalit vadiqtes fshati Gojan i Madh, Njësia Administrative "Gjegjan"
26. Rehabilitimi i kanalit vadiqtes fshati Dom, Njësia Administrative "Gjegjan"
27. Rehabilitimi i KUZ Gjegjan, Njësia Administrative "Gjegjan"
28. Rehabilitimi kroni "Zojes", Njësia Administrative "Rrape"
29. Hapje degëzim i ri rruga lagjia Mataj, Njësia Administrative "Rrape"
30. Tombino rruga Prozhëm, Njësia Administrative "Rrape"
31. Tombino rruga Meçe, fshati Meçe, Njësia Administrative "Rrape"
32. Hapje degëzim i ri rruga lagjia Hoxhaj+Nika, Njësia Administrative "Rrape"
33. Hapje degëzim i ri rruga Buhot Qendër, Njësia Administrative "Rrape"
34. Riparim ura këmbësore Shmi, fshati Breg, Njësia Administrative "Rrape"
35. Riparim ura këmbësore Krov-Meçe, Njësia Administrative "Rrape"
36. Riparim ura këmbësore Barxhanve, fshati Kabash, Njësia Administrative "Rrape"
37. Riparim ura këmbësore Bojaxhi, fshati Blinisht, Njësia Administrative "Rrape"
38. Riparim ujësjellësi shkolla Kabash, Njësia Administrative "Rrape"
39. Riparim ujësjellësi shkolla Laskaj, fshati Blinisht, Njësia Administrative "Rrape"
40. Rehabilitimi i kanalit vadiqtes fshati Kabash, Njësia Administrative "Rrape"
41. Rehabilitimi i kanalit vadiqtes Laskaj, fshati Blinisht, Njësia Administrative "Rrape"
42. Rehabilitimi i kanalit vadiqtes lagjia Deliaj, fshati Blinisht, Njësia Administrative "Rrape"

43. Rehabilitimi i kanalit vaditës Sumakull, fshati Bicaj, Njësia Administrative “Rrape”
44. Rrethimi varrezave Breg, Njësia Administrative “Rrape”
45. Rrethimi varrezave Memaj, fshati Buhot, Njësia Administrative “Rrape”
46. Ndërtim urë auto mbi lumin Lum-Prift, Njësia Administrative “Qelëz”
47. Riparim i urës këmbësore Buzhalë, Njësia Administrative “Qelëz”
48. Riparime/ndërrhyrje në kanalet vaditëse (Bushat, Breg-Qelëz, Buzhalë), Njësia Administrative “Qelëz”
49. Rrethim i varrezave (Dedaj, Bushat, Qerret i Vogël)
50. Ujësjetllës shkolla e mesme “8 Dhjetori”, Njësia Administrative “Qelëz”
51. Ndërtim rrugë auto Zezaj, Bashkia Pukë
52. Rehabilitimi rezervuarit Kukaj, Bashkia Pukë
53. Përmirësimi i rrjetit infrastrukturor, Bashkia Pukë

Ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit nr.139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”.

Hartuesi

Drejtori i Urbanistikes

Alda MEMA



Juristi

Igli TRUPJA



KRYETARI

GJON GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA PUKË

RELACION

PËR PROCEDURAT E PRIORITETEVE PËR INVESTIME E SHËRBIME PËR VITIN 2021

Në kuadër të hartimit të objektivave për Rivitalizimin Urban dhe atë Rural Bashkia Pukë ka hartuar për vitin 2021 listën e prioriteteve për investime, ku janë të përfshira shërbime, sistemime dhe ndërtime të objekteve të ndryshme.

Në qytetin e Pukës me zhvillimet e reja po aplikohen projekte të ndryshme rikualifikuese dhe rivitalizuese të tij, të cilat po krijojnë perspektiva të reja zhvillimi ekonomik dhe social për qytetin dhe banorët e zonës.

Duke u mbështetur në gjendjen fizike të infrastrukturës ekzistuese, në plotësimin e nevojave në rritje për investime në infrastrukturë në territorin e Bashkisë Pukë, si dhe për të krijuar një mjedis sa më funksional, estetik dhe bashkëkohor brenda këtij territori, janë parashikuar rikonstruksionet e rrugëve, urave, vendosja e tombinove, rehabilitimi i hapësirave publike, të cilat do të kenë impakt të drejtëpërdrejtë te nevojat e qytetarëve.

Gjithashtu një përqindje të konsiderueshme të prioriteteve e zë ndërhyrja për rehabilitimin e kanaleve vaditëse të njësive administrative, situata aktuale e të cilave është e amortizuar dhe ka nevojë të madhe për ndërhyrje.

Me qëllim orientimin e të rinjve dhe të disa grupmoshave, drejt aktiviteteve dhe disiplinave të ndryshme lidhur me turizmin, prioritet për bashkinë ka përmirësimi dhe krijimi i ambienteve të ndryshme, si rehabilitimi i rezervuarit Kukaj, si atraksion i ri turistik për vitin 2021.

Lista për investimet përmban objekte të ndryshme, në të cilat është e nevojshme ndërhyrja për të ofruar një shërbim më të mirë komunitetit.

Për sa më sipër kërkohet nga ana juaj miratimin e projekt-vendimit për procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2021.

JU FALEMINDERIT!

Drejtor i Urbanistikës dhe
Planifikimit të Territorit
ALDA MEMA

KRYETARI I BASHKISË

GJON GJONAJ